

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR
TIRANE

Nr. 902 Akti

Datë: 27. 05. 2017

VENDIM
“NE EMER TE REPUBLIKES”

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane e përbërë nga:

GJYQTAR: ERVIN POLLOZHANI

asistuar prej sekretares gjyqësore **Gencjana Dada**, në Tiranë sot më datë **27. 05. 2017**, mori në shqyrtim materialin procedures me **Nr. 902 Akti**, që i përket:

ANKUES: **H. XH.**, i biri i E. dtl. 29. 11. 19.., lindur ne Vlore dhe banues ne Tirane, Rruga "...", Vila 8/1, me cilesine e permbaruesit gjyqsor privat, i perfaqesuar ne gjykim me prokure te posaçme Nr. 1125 Rep. Nr. 896 Kol. dt. 13. 03. 2017 nga av. Liljana Gjomema.

KUNDER: Prokuroria prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, perfaqesuar nga prokurori z. Gjergji Tako.

OBJEKTI: Ankim ndaj vendimit per sekuestrimin e dokumentave origjinale dt. 24. 05. 2017 te Prokurorit prane Prokurorise se Rrethit Gjyqesor Tirane, z. Gjergj Tako.

BAZA LIGJORE: Neni 212 i K. Pr. Penale.

Gjykata pasi administroi provat shkresore, dëgjoi pretendimet perfundimtare te perfaqesueses se ankuesit dhe vet ankuesin, i cili kërkoi: *Pranimin e kerkeses (ankeses) siipas objektit te saj*, prokurorin i cili kerkoi: *Mospranimin e ankimit si te pa bazuar ne ligj dhe ne prova dhe e shqyrtoi çështjen në tërsi, në përfundim të saj,*

VËREN :

Se, ankuesi H. Xh. me cilesine e permbaruesit gjyqesor privat, i eshte drejtuar Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane me ankimin formal kunder vendimit dt. 24. 05. 2017 te Prokurorit te Prokurorise se Rrethit Gjyqesor Tirane, z. Gjergji Tako “Per sekuestrimin e dokumentave origjinale”.

Ka rezultuar se nga ana e shtetasit S. I.me dt. 19. 12. 2016 eshte paraqitur nje kallzim penal prane Prokurorise se Rrethit Gjyqesor Tirane ndaj shtetasit H. Xh. per kryerjen e vepres penale te “shperdorimit te detyres”, e parashikuar nga Neni 248 i K. Penal. Sipas ketij kallzimi shtetasit S. eshte kreditor ne nje proces ekzekutimi me debitor shoqerine “P...” sh.p.k. me titull ekzekutiv “Deklarate noterieale Nr. dt. 05. 09. 2012”, per te cilen Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane me vendimin Nr. ... Akti dt. 22. 07. 2015, ka leshuar urdherin e ekzekutimit. Ekzekutimi i ketij titulli eshte marre persiper nga ankuesi, permbaruesi gjyqesor privat H. Xh. me te cilin kreditori (kallzuesi) ka kontraktuar nje marreveshje sherbimi permbarimore.

Sipas kallzimit shtetasi S. pretendon se permbaruesi ka shperdoruar detyren duke mosvepruar konfom ligjit si me ekzekutimin plotesisht te tituje ekzekutiv dhe me tej as me dorezimin e dosjes permbarimore kreditorit, pas kerkeses se ketij te fundit per terheqjen e saj pasi ai do te vazhdonte keto veprime me permbarues te tjere privat.

Sipas kallzuesit nga ana e permbaruesit gjyqesor eshte refuzuar nje gje e tille me pretendimin se nga ana e kreditorit duhet te paguhet shuma prej 1. 627. 150 lek, gje qe kallzuesit i eshte dukur si nje gjobvenie, pasi me pare ai i ka paguar atij ne menyre informale, pa fature tatemore apo kupon tatemor, nje shume prej 150. 000 lek dhe shuma tjeter e pretenduar nuk i eshte thene qe e kishte per detyrim per ta paguar.

Nga ana e prokurorise eshte regjistruar procedimi penal Nr. 1882 i vitit 2017 nga prokurori z. Gjergj Tako.

Nder veprimet e tija hetimore per kete procedim, nga ana e prokurorit nder te tjera eshte marre dhe vendimi “Per sekuestrimi e dokumentave” dt. 24. 05. 2017, konkretisht gjithe praktikes permbarimore te dosjes permbarimore me kreditor S. I.dhe pale debitore shoqeria “P...i” sh.p.k. sipas Urdherit te ekzekutimit Nr. 5574 Akti dt. 22. 07. 2015 te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane. Ngarkohet oficere e policise gjyqesore Elida Doçi e cila duhet te mbaje procesverbalin e ekzekutimit ne prani te punonjesit i cili ka ne posedim dosjen perkatese.

Ky vendim i eshte njoftur me shkresen percjellese Nr. ... Prot. dt. 24. 05. 2017 permbaruesit gjyqesor H. Xh., i cili nga ana e tij ne te njejten date me ane te perfqesueses se tij ligjore ka paraqitur ankimin formal ne gjykate ndaj ketj vendimi.

Ne ankesen formale por edhe gjate gjykimit, pala ankuese ka shprehu se, se pari: ky vendim eshte i gabuar pasi ne pjesen arsyetuese te tij krahas rr Ethanave te faktit nuk jepet

asnje lloj shpjegimi se perse eshte e nevojshme kryerja e sekuestrimit te kesaj dosje originale.

Hetimi nga ana e organit te prokurorise eshte regjistruar qe ne shkurt te vitit 2017, pra ka tre muaj dhe prokurori nuk ka dale ne nje konkluzion nese ka dyshime te bazuara ne prova per kryerjen e vepres penale te parashikuar nga Neni 248 i K. Pr. Penale per te cilin ai ka filluar procedimin. Ne keto kushte ne kuptim te Nenit 208 te K. Pr. Penale ai nuk mund te ligjeroj sekuestrimin e dokumentave.

Praktika dokumentare eshte kqyrur dhe marre paraprakisht nga prokurori me ane te oficerit te policise gjyquesore dhe per kete shkak nuk ka arsy per te marre provat origjinale pasi nuk ka se çfare te zbulojte tjeter me marrjen e origjinalit te ketyre dokumentave. Prokurori nuk ka patur asnje urgjence per marrjen e ketij vendimi ne lidhje me sekuestron.

Se fundmi, nese ky vendim do te ligjerohej duke mos u shfuqizuar si i tille, atehere ai do te sillte nje dem te madhe tek pala ankuese pasi do te pezullonte ne menyre te metejshme veprimet permbarimore ne menyre te padrejte, gje qe si e tille mund te kryhet vetem ne nje proces civil dhe konform nenit 615 te K. Pr. Civile.

Nga ana e tij prokurori prapsoi se ankimi nuk duhet te pranohet pasi se pari: pala ankuese nuk legjitimohet per te ushtruar kete ankim, sepse kuptimi literal i nenit 212 te K. Pr. Penale ben fjale per ankim ndaj nje sekuestrimi te kryer efektivisht si i tille. Ne rastin objekt shqyrtimi rezulton sipas permajtjes se procesverbalit mbi zbatimin e vendimit te sekuestrimit dt. 24. 05. 2017 te mbajtur nga oficere e policise gjyquesore Elida Doçi se efektivisht ky vendim nuk eshte zbatuar pasiqe eshte refuzuar nga pala ankuese. Pra efektivisht ky vendim nuk ka prodhuar asnje pasoje, nuk eshte bere sekuestrimi fizik i dokumentave.

Se dyti: lidhur edhe nese do te pranohej e kunderta e sa me siper, lidhur me themelin e ankimit, ai nuk qendron si i tille pasi veprimet jane kyer ne perputhje me qellimin e hetimit dhe se vendimi konkret i sekuestros eshte proceduralisht i ligjshem dhe i nevojshem per te verifikuar prokurori teresine e veprimeve procedurale pare ne raport me rrethanat objektive dhe subjektive qe kerkohen te verifikohen per vepren penale per te cilien ankuesi po hetohet.

Gjykata nga ana e saj, pasi mori ne shqyrtim kerkesen (ankesen) ne rapport me dispozitat procedurale penale dhe provat e lejuara per shqyrtim vendos te mos e pranoje ate pasi e gjen te pabazuar ne ligj dhe ne prova.

Neni 212 i K. Pr. Penale percaktojne se : "*I pandehuri, personi tek i cili jane sekuestruar sendet dhe ai qe ka te drejten e kerkimit te tyre mund te bejne ankim ne gjykate kunder vendimit te sekuestrimit. 2. Ankimi nuk e pezullon zbatimin e vendimit*".

Ne interpretim te sispozites se siperpermendur, referuar rrrethanave te faktit provohet se, se pari, veprimi efektiv i sekuestrimit te dokumentit nuk eshte realizuar konkretisht, pasi dosja permbarimore e permbaruesit gjyqesor nuk eshte sekuestruar, kjo sipas permbajtjes se procesverbalit te zbatimit te vendimit te sekuestrimit te mbajtur nga oficere e policise gjyqesore e ngarkuar per kete qellim Elida Doci.

Se dyti, edhe ne themel pretendimet e pales ankuese nuk qendrojne si te tilla ne teresine e tyre, pasi eshte ne diskpcionin e organit te prokurorise disponibiliteti mbi nevojat e sekuestrimit te nje sendi apo dokumenti, i nevoshem per hetimin penal te nje procedimi penal.

Sipas shpjegimeve te prokurorit ne seance, nevojshmeria e sekuestrimit te tyre (dokumentave origjinale) eshte per faktin per te evidentuar teresine e veprimeve proceduriale ligjore te permbaruesit gjyqesor privat pare ne raport me pretendimet e parashtruara ne kallzim, kjo per vet natyren e dispozites penale per te cilen ai po hetohet (shperdorim detyre), si dhe te vleresimit te ligjshmerise se vleres se tarifes permbarimore te pretenduar nga permbaruesi (1. 627. 150 lek), kundrejt kreditorit (kallzuesit).

Nga ana tjeter eshte i vertete fakti se praktika permbarimore eshte kqyrur dhe marre nga ana e oficerit te policise gjyqesore, por si e tille ajo eshte mare kopje e pa njesuar me originalin dhe kjo gje jo per faj te oficerit te policise gjyqesore. Ne kete menyre mbi keto dokumenta te panjesuara me originalin, prokurori nuk mund te shpreh qendrime ligjore.

Sa me siper, gjykata, çmon se taktika e hetimit është një element ekskluziv që i përket organit procedues (prokurorisë). Është në kompetencën dhe çmimin e saj që gjatë veprimeve hetimore paraprake të ekzistojë nevoja e domosdoshme për sekuestrimit e dokumentave, sendeve, etj. Në rastin objekt gjykimi referuar shpjegimeve të dhëna nga prokurori si dhe duke pasur parasysh dhe rrezikshmërinë e vepres, gjykata çmon se vendimi i marre i sekuestrimit te dokumentave dt. 24. 05. 2017, përmbushet plotësisht me rrrethanat e çështjes në hetim.

PER KETO ARSYE :

Gjykata. bazuar në Nenet 212 e vijues të K. Pr. Penale,

VENDOSI :

- Mos pranimin e ankimit te bere nga ankuesi, H. Xh. me cilesine e permbaruesit gjyqesor privat, ndaj vendimit dt. 24. 05. 2017 te prokurorit “Per sekuestrimin e dokumentave origjinale”.
- 2. Kunder ketij vendimi lejohet ankim ne Gjykaten e Apelit Tirane, sipas ligjit.

3. U shpall sot me dt. 27. 05. 2017, ne Tirane.

SEKRETARE

GENCJANA DADA

GJYQTAR

ERVIN POLLOZHANI